



VENDIM

Nr. 188, Datë 23.11.2016

**MBI
KËRKESËN PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË
“DENAS POWER“ SH.P.K., NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE
GENERALE ALBANIA” SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44 pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nenit 20 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë“, si dhe në zbatim të neneve 2, 3 dhe 4 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licensuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016.; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” gjithashtu dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e ERE Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin dhe informacionin plotësues mbi kërkesën e shoqërisë “DENAS POWER” sh.p.k, për lënie peng asetesh në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike

Konstatohet se:

Në Aplikimin e shoqërisë “DENAS POWER” sh.p.k kërkohej transferimi i asetëve të cilat nuk rezultojnë të jenë asete të të licensuarit.

Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në nenin 44 dhe Rregullorja e procedurave të transferimit të asetëve nga të licensuarit përcaktojnë autoritetin e ERE për trajtimin e kërkesave për transferim të asetëve të të licensuarit si më poshtë:

- *shitje, dhënie me qera, transferimi, hipotekim, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose asetëve fikse të të licensuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Deklarimin e mungesës së juridiksionit administrativ të ERE për kërkesën e shoqërisë “DENAS POWER“ sh.p.k., për lënie peng të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme që do të krijojë në të ardhmen e që do të

shërbejnë vetëm për veprimtarinë për të cilën është licencuar nga ERE, në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.